



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.09.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 17.07.2018 dhe 19.07. 2018.
2. Miratimi i kalendarit dhe programit të punës së komisionit.
3. Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014.”

Marrin pjesë :

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia. Luan Duzha, Luan Harusha, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Klodjana Spahiu dhe Milva Ekonomi .

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Anduel Xhindi, Luan Rama, Myslym Murrizi, Ervin Salianji, Paulin Sterkaj, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi dhe Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Besfort Lamallari - Zëvendësministër i Brendshëm

Jeton Xoxe - Specialist në Drejtorinë e Marrëveshjeve

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj - Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Kjo është mbledhja e parë për këtë sesion parlamentar.

Me rastin e kësaj mbledhjeje më lejoni t'u uroj të gjithë kolegëve deputetë të këtij komisioni, punë të mbarë në këtë sesion të ri parlamentar, posaçërisht në komisionin ku bëjmë pjesë!

Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 17.07.2018 dhe 19.07.2018. Besoj se nuk ka asnjë vërejtje nga kolegët.

Pika e dytë e rendit të ditës është miratimi i kalendarit dhe programit të punës së komisionit. Programi dhe kalendarin janë dy dokumente, të cilat janë miratuar edhe në Kuvendin e Shqipërisë. Në programin dhe kalendarin që u është bërë me dije të gjithë anëtarëve të këtij komisioni, parashikohet edhe se çfarë duhet të bëjë komisioni ynë përgjatë tri javëve në vijim.

Çështja tjetër e rendit të ditës është shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014.”

Për të prezantuar këtë marrëveshje ndryshuese mes Republikës së Shqipërisë dhe Europol-it kemi dy përfaqësues nga Ministria e Brendshme, zotin Besfort Lamallari, zëvendësministër, si dhe zotin Jeton Xoxe, specialist në Drejtorinë e Marrëveshjeve.

Faleminderit!

Ju lutem, se pari na bëni një prezantim të marrëveshjes! Më pas edhe ne do të themi dy fjalë për marrëveshjen dhe mandej, pyetjet që mund të kenë anëtarët e Komisionit të Sigurisë.

Besfort Lamallari - E nderuar kryetare e komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë të këtij komisioni,

Jam i kënaqur që kam mundësinë të shpjegoj rëndësinë e kësaj marrëveshjeje.

Konkretisht, projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash, që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014”, ka si

qëllim amendimin e aneksit të parë të marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Europol-it. Këto amendime janë propozuar në kuadrin e ndryshimeve statutoire që ka pësuar edhe Europol-i së fundi.

Në datën 1 maj 2017 ka hyrë në fuqi rregullorja e re e Europol-it dhe për rrjedhojë ka ndryshuar edhe kuadri ligjor i kësaj organizate.

Mandati i ri i Europol-it mbulon edhe vepra të tjera penale, që kanë të bëjnë me krime të rënda, terrorizimin, format e tjera të krimit të organizuar e të tjerë, që prekin dy ose më shumë vende të Bashkimit Europian, ashtu siç janë listuar edhe në aneksin e parë të rregullores së re të Europol-it.

Në aneksin e parë të kësaj marrëveshjeje janë vendosur fushat e krimit që mbulohen nga kjo organizatë.

Konkretisht, shtesat e reja në këtë aneks janë: terrorizmi; krimi i organizuar; krimi kundër interesave financiare të Bashkimit Europian; manipulimi i brendshëm dhe manipulimi i tregjeve financiare; krimi mjedisor, duke përfshirë edhe ndotjet nga anijet; abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, duke përfshirë materialet abuzive dhe joshëse ndaj fëmijëve për qëllime seksuale, si dhe gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës. Pra, këto 7 kategori janë të reja në aneksin e marrëveshjes së Europol-it.

Në total kemi 30 fusha, që mbulohen nga kjo organizatë. Kjo i jep një shtysë të jashtëzakonshme luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, e cila në bashkëpunim me vendet e treta, përfshirë edhe vendin tonë, rrit diapazonin e gamës së informacioneve që mund të shkëmbehen, qoftë në nivel operacional mes zyrave kombëtare, pra përfaqësisë në vendit tonë dhe Europol-it, por edhe oficerëve ndërlidhës që shkëmbehen.

Së shpejti do të kemi edhe një oficer ndërlidhës nga Europol-i, që do të vendoset në Tiranë, por kjo mbetet një marrëveshje për t'u diskutuar më vonë.

Për momentin është shumë e rëndësishme të theksojmë se ky amendim i marrëveshjes, jo vetëm që është një ndryshim si rrjedhojë e ndryshimeve statutoire të vetë Europol-it, por i shërben më mirë luftës kundër krimeve të organizuara dhe krimeve të rënda, që ka prioritet qeveria shqiptare në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Sigurisht, Europol-i zë një peshë të pazëvendësueshme në arenën europiane në luftën kundër këtyre formave të kriminalitetit.

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Në fakt, meqenëse gjatë javës nuk caktuam një relator nga anëtarët e komisionit, do të më duhet ta relatoj vetë marrëveshjen, e cila ka ardhur për miratim në parlament.

Në fakt, në 2014-n Republika e Shqipërisë ka lidhur një marrëveshje me Europol-in ose me Zyrën e Policisë Europiane, marrëveshje që bashkëngjitur përmban edhe një aneks, ku përcaktohet gjithë gama ose katalogu i krimeve, për të cilat Republika e Shqipërisë dhe Zyra e Policisë Europiane (Europol) detyrohen të bashkëpunojnë dhe të mbështesin njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjellë, sipas specifikave që përmban edhe marrëveshja, që është ratifikuar me ligj në vitin 2014.

Natyrisht, ka qenë një hap shumë pozitiv në punën e organit që ka përgjegjësinë e sigurimit të rendit në Shqipëri, për faktin se më në fund bëhemi edhe ne pjesë e të njëjtave detyrime dhe të drejta si vendet e tjera të Bashkimit Europian, që bashkëpunojnë me njëra-tjetrin në kuadër të policive të tyre.

Në marrëveshjen e vitit 2014 është rënë dakord që, në rast se palët do të bënin ndryshime në detyrimet e tyre, atëherë nuk do të kishte nevojë për një marrëveshje të re, por do të mjaftonte letra e tyre drejtuar autoriteteve shqiptare dhe dakordësia e shprehur nga ana jonë për të ardhur në parlament dhe për ta ratifikuar ndryshimin.

Në rastin konkret, nga ajo që kuptohet nga letra e përfaqësuesit të Zyrës së Europol-it, ka ndodhur një përditësim i aneksit, ku parashikohen të gjitha veprat penale, për të cilat Policia Europiane dhe Republika e Shqipërisë detyrohen të bashkëpunojnë.

Zoti zëvendësministër, do t'ju kërkoja ta thoshit në mënyrë specifike se cila është pjesa e shtuar, sepse jo gjithçka është e shtuar aty. Terrorizmi dhe disa forma kryesore të krimit të organizuar dhe krime të tjera të rënda, kanë qenë të parashikuara edhe të vitin 2014. Ndoshta duhet të jemi pak më koncizë te detajet, se cilat janë veprat që janë shtuar, për të kuptuar se çfarë realisht lipset të përditësohet nga ana jonë.

Natyrisht, Kuvendi i Shqipërisë e gjen me vend ta mbështesë përditësimin e kësaj marrëveshjeje. Është shumë e rëndësishme për autoritetet shqiptare të kenë mbështetjen në luftën kundër krimit e një autoriteti europian, në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, formave të tjera të krimit, ashtu siç janë listuar në aneks, qoftë në përmbajtjen që kishte aneksi kur lidhëm marrëveshje për herë të parë në vitin 2014, qoftë edhe mbas ndryshimeve që kanë ndodhur në maj të vitit 2017.

Në momentin kur Kuvendi i Shqipërisë do ta miratojë këtë përditësim marrëveshjeje, kuptohet që hyjnë në fuqi detyrimet fillestare të marrëveshjes sipas listës së re të përditësuar. Ky është gjithë qëllimi përse qeveria sjell në Kuvendin e Shqipërisë një propozim të tillë.

Kështu që do t'i ftoja të gjithë kolegët ta mbështesin këtë propozim dhe t'i hapim rrugë një bashkëpunimi më të efektshëm dhe më të frytshëm të Policisë së Shtetit me Zyrën e Policisë Europiane.

Kaq desha të thosha për marrëveshjen në fjalë.

Nuk e di nëse ndonjë nga kolegët ka ndonjë pyetje për t'ia drejtuar zëvendësministrit ose specialistit të drejtorisë së marrëveshjeve.

Po, zoti Qefalia.

Faleminderit!

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Kisha një pyetje. Kjo është një marrëveshje standarde dhe vendet e Bashkimit European automatikisht e kalojnë pa ratifikim në parlamentet e tyre. Sa prej vendeve të tjera, si Shqipëria, e kanë kaluar këtë marrëveshje?

Faleminderit!

Besfort Lamallari – I nderuar deputet, në dijeninë time, Serbia dhe Maqedonia janë në proces për ta konsideruar dhe për ta ripërtërirë këtë marrëveshje. Bosnja, për problematikat që ka, e ka më të komplikuar procesin, ndërsa Shqipëria është vendi i parë në këtë fazë, pra që e ka kaluar në komisione dhe është pranë ratifikimit të marrëveshjes së ripërtërirë.

Për sa i përket çështjes që ngritët ju, zonja kryetare, në fakt, të krijohet përshtypja që Europol-i dikur mbulonte edhe çështjet e krimit të organizuar, pra, trafikun e drogës, klandestinët, ndërsa krimin e organizuar si koncept më vete, jo. Ky konstatim është nga një shqyrtim i detajuar i aneksit dhe këto çështje nuk figuronin më parë në rregulloren e Europol-it, pra terrorizmi, krimi i organizuar, krimi kundër interesave financiare. Ato 7 pika, që unë i përmenda, janë shtesa që janë bërë në marrëveshje dhe në letrën shoqëruese të drejtorit të Europol-it.

Ermonela Felaj- Ka një pyetje zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti zëvendësministër, faleminderit për sqarimin!

Sigurisht, kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme në luftën kundër krimit të organizuar dhe për faktin se Shqipëria bashkëpunon me Europol-in.

Kisha një pyetje. Këtu thuhet “pjesëmarrje në ekipet e përbashkëta të hetimit”. Në rastet kur ne do të kemi një ekip të përbashkët hetimi për një vepër të caktuar, a ka nevojë për një

ndryshim ligjor në Shqipëri për krijimin e këtij ekipi të përbashkët hetimor? A kemi ne ndonjë eksperiencë të mëparshme në lidhje me këtë?

Pyetja tjetër: Si kemi ecur ne me shkëmbimin e informacionit? Afërsisht një rritje në përqindje të informacionit, ndërmjet Europol-it dhe Zyrës në Tiranë.

Besfort Lamallari – Për sa i përket pyetjes së dytë, po të shohësh statistikën e mesazheve të shkëmbyera përmes kanalit SIENA me Europol-in, nga viti në vit ato janë në rritje. Aktualisht, nuk mund të them ndryshimet në përqindje nga viti në vit, por absolutisht janë në rritje. Sigurisht, Shqipëria ka mundësi të bëjë shumë më tepër në krahasim me vendet e treta, po themi, edhe pse në raport me totalin, pra me vendet e Bashkimit Europian dhe vendet e treta, qëndron shumë mirë për sa i përket proaktivitetit në shkëmbimin e të dhënave. Jo gjithmonë vendet anëtare kanë të njëjtën dinamikë përgjigjesh. Vende të ndryshme janë më të gatshme për të dhënë informacione ose për t'iu përgjigjur kërkesave të përcjella nga Zyra Kombëtare Europol në Tiranë.

Për sa u përket ekipeve hetimore, mund të them se çdo lloj informacioni shkëmbehet mes Zyrës Kombëtare Europol Tirana dhe Hagës, selisë qendrore të Europol-it. Për çdo vend që paraqet interes, si për Shembull, Spanja, në varësi të çështjes konkrete, ekipet hetimore aktivizohen dhe bashkëpunojnë edhe në nivel operacional policor. Kemi pasur raste të ndryshme, ku operacione të suksesshme janë realizuar falë bashkëpunimit dhe koordinimit të ngushtë me Europolin.

Ermonela Felaj – Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, një pyetje nga zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë e vlerësoj maksimalisht ardhjen dhe përditësimin e projektligji për marrëveshjen që kemi me Interpolin. Siç e përmendët edhe ju, janë përditësuar shtatë kategori, ku një ndër është edhe përditësimi i marrëveshjes për krimin mjedisor ose anijet. E keni fjalën për anijet që lundrojnë në ujërat ndërkombëtare apo për anijet që lundrojnë në ujërat e Republikës së Shqipërisë?

Besfort Lamallari – Në nivel europian krimi mjedisor sa vjen dhe merr një vëmendje të shtuar si në nivel politikbërjeje ashtu edhe nga agjencitë ligjzbatuese. Ndotja e ujërave nga anijet është një problem që është konstatuar edhe nga Komisioni Europian. Përderisa Shqipëria bashkëpunon me Europolin dhe ndan kufirin detar me vende të Bashkimit Europian, ka detyrimin, në kuadër të kësaj marrëveshjeje, që të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me Greqinë, Italinë ...

Kjo shtohet në fushën e kompetencave të bashkëpunimit të ndërsjellë.

Ermonela Felaj – Kam një pyetje për zotin Xoxe.

Dokumenti i ndryshuar, që i përket shtojcës 1 të Rregullores së Europolit dhe që kuptohet duhet të ketë ardhur bashkë me letrën e përfaqësuesve të zyrës së Europolit, është sjellë në ndonjë nga komisionet parlamentare në Kuvend? E kam fjalën për përkthimin zyrtar, nuk po kërkoj dokumentin në anglisht apo frëngjisht, që ju ka ardhur juve. Për korrektesë, përditësimi i ndodhur në shtojcë duhet të ishte pjesë e dokumentacionit.

Jeton Xoxe – Faktikisht, përkthimi që është zyrtarizuar nga Ministria e Drejtësisë është përkthim i shtojcës së sjellë nga zyra e Europolit.

Ermonela Felaj – Ne shikojmë vetëm letrën. Ku është shtojca, sepse nuk e kemi në dokument?

Jeton Xoxe – Shtojca 1 është bashkëlidhur ...

Nuk e di nëse ka ardhur, sepse kur është prezantuar projektligji, është propozuar me letrën propozuese për shtojcën 1 të përditësuar dhe letrën konfirmuese.

Shtojca 1 me përkthim të zyrtarizuar nga Ministria e Drejtësisë është ekuivalente e shtojcës që ka propozuar zyra qendrore e Europolit.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se nuk ka më pyetje të tjera nga kolegët.

Kalojmë në miratimin e projekt marrëveshjes. I ftoj kolegët për të votuar.

Kush është dakord me nenin 1 të projekt marrëveshjes? Faleminderit! Të gjithë janë dakord. Kundër dhe abstenim nuk ka. Miratohet neni 1.

Neni 2. Hyrja në fuqi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka?

Dokumenti miratohet.

Faleminderit zoti zëvendësministër dhe zoti specialist për prezencën tuaj në komision.

Ditë të mbarë!

Ju lutem anëtarëve të komisionit që qëndrojnë edhe pak minuta për të diskutuar programin dhe kalendarin e komisionit.

Siç kemi rënë dakord, në programin e punës së këtij komisioni, në bashkëpunim edhe me zyrën shqiptare të OSBE-së, ne kemi përcaktuar një kalendar vizitash në të gjitha pikat e kalimit kufitar, përfshirë këtu portin e Durrësit dhe aeroportin e Rinasit. Keni një draft paraprak. Kemi planifikuar që vizitën e parë ta kemi në datat 2-3 tetor në Pogradec dhe Korçë. Këtu nuk do të jetë vetëm komisioni ynë, por edhe Komisioni i Veprimtarive Prodhuese. Do të diskutojmë për krimin mjedisor. Është një temë që e ka marrë përsipër ta trajtojë zyra e OSBE-së në Shqipëri me ndihmën e dy komisioneve tona. Meqenëse do të jemi në këtë aktivitet, menduam që edhe vizitën në pikën kufitare të Qafë Thanës ta realizojmë gjatë kësaj kohe. Jemi dakord? Pak a shumë i kemi marrë masat që për datat 2 dhe 3 të jenë të mbuluara të gjitha gjërat për sa i përket vajtjes dhe qëndrimit tonë atje. Pra, është folur paraprakisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, vetëm një natë do të rrimë.

Ne do të ikim në datën 2, do të qëndrojmë në Korçë dhe të nesërmen do të kthehemi në Tiranë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E martë dhe e mërkurë. Jemi kujdesur që të zgjedhim ditët që nuk ..

Komisioni i Veprimtarive Prodhuese është dakord. Për datat 2 dhe 3 programi është avancuar, sepse janë marrë masat. Ka ngelur vetëm për një konfirmim të fundit. Besoj se të gjithë jemi dakord që ta ndjekim këtë plan. Ndërkohë, vizitat e tjera përgjithësisht janë planifikuar në datat që u takojnë ditëve të marta dhe të mërkura. Vetëm vizita në Qafë Botë do të bëhet të hënën dhe të martën. Ne kemi menduar që të nisemi pas mbledhjes së grupit, nëse do të ketë mbledhje grupi, pra, të mos nisemi menjëherë dhe t'i bëjmë të dyja vizitat, si në Kakavi edhe në Qafë Botë. Në fund, pasi t'i kemi parë të gjitha pikat e kalimit kufitar, portin dhe aeroportin, të dalim me një raport pune me sugjerime apo vërejtje sipas gjërave që ne do të konstatojmë në vend.

Puna është ndërtuar në mënyrë të tillë, siç bëmë me vizitat gjatë sesionit të shkuar, që në të gjitha pikat e kalimit kufitar, nga administrata që punon atje të na bëhet një prezantim i punës. Natyrisht, ne do të jemi në kushtet për ta inspektuar të gjithë këtë. Ky është plani në përgjithësi, pastaj mund të kemi ndonjë lëvizje në varësi të axhendës që kemi këtu. Nuk mund të themi që do të jemi fiks në çdo gjë siç e kemi diskutuar me OSBE-në, e cila na mbështet në të gjithë pjesën e lëvizjeve. Jemi dakord në parim, që brenda të gjithë muajit ne ta mbyllim të gjithë këtë kalendar të takimeve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo do ta kapë muajin tetor, por e menduam për të mos krijuar shumë shkëputje dhe për të dalë realisht me një raport të konsoliduar në fund. Menduam që të shfrytëzojmë çdo javë. Besoj se mund të kemi lëvizje, Xhemal. Nesër do të mbledhet Konferenca e Kryetarëve dhe Komisionit të Sigurisë do t'i kalojë ligji për ekzekutimin e vendimeve penale, Kodi Penal dhe Kodi Ajror, kështu që do të kemi edhe ndonjë shkëputje. Në teori, të gjitha vizitat mund të bëhen edhe për dy muaj, por ne kemi planifikuar që ditët që nuk do të kemi mbledhje të bëjmë një vizitë në njërin nga pikat kufitare. Pikat që i kemi më afër do t'i bëjmë brenda ditës, kurse në pikat e largëta, Kakavi, Qafë-Botë dhe Qafë-Thanë do të qëndrojmë nga një natë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, edhe në Kukës.

Ndërkohë, është biseduar që të shkojmë edhe në Muriqan. OSBE-ja ka marrë përsipër dhe është në tratativa që, me rastin e shkuarjes sonë në Muriqan, ne të mund të zhvillojmë një takim në Tivat me Komisionin e Sigurisë atje. I thashë këto për të ditur nëse jemi dakord në parim me këtë plan, kurse për sa u përket datave, ato do të varen nga angazhimet që do të kemi. Jemi dakord me programin dhe kalendarin.

Kam edhe një ftesë të fundit, të hapur. Në datën 26, pra të mërkurën e javës tjetër, me iniciativë të koleges sonë, Elona, organizohet një workshop me rrjetin e parlamentarëve anglezë, por jo vetëm, sepse ka edhe vende nga rajoni, ku do të diskutohet për trafikimin e qenieve njerëzore. Për anëtarët e Komisionit të Sigurisë ftesa është e hapur, kurse nga komisionet e tjera kemi ftuar vetëm kryetarët. Ky workshop do të zhvillohet në orën 10. Po jua dërgojmë të gjithëve draftin e programit në mënyrë që kush ka mundësi ta ndjekë. Është interesant, sepse synon të krijojë një rrjet të parlamentarëve që llojnë për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore edhe në Shqipëri. Nëse dikush ka dëshirë të dedikohet për këtë pjesë është i ftuar të na ndjekë. Këto çështje kishim për sot

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Pjerin Ndreu

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Antonela Veshi